



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:268631  
Datë: 28.04.2021  
Numri i dokumentit: 01743280

A.nr. 1005/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu, në konfliktin administrativ të paditësit R. K. “...” me adresë në Rrugën “...”, nr. ..., Prizren, kundër të paditurit Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me bazë juridike, anulim i vendimit nr. 115/2017, i datës 10.05.2017, pas shqyrtimit kryesor publik, me datën 06.04.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit R.K. “...” me adresë në Rrugën “...”, nr. ..., Prizren me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr. nr. 115/2017, i datës 10.05.2017 i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e datës 15.06.2017, ka kërkuar nga Gjykata që të aprovohet si e bazuar padia e paditësit e ushtruar kundër vendimit të Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Në padinë e tij, paditësi pohon se e paditura me vendimin kontestues ankesën e paditësit e hudh poshtë si të paafatshme, me arsyetimin se paditësi vendimin e ka pranuar me datën 15.03.2017, ndërsa ankesën e ka paraqitur me datë 22.04.2017. Paditësi konsideron se ankesën ndaj vendimit të të paditurës e ka parashtruar me kohë, e këtë e vërteton ekspedimi rekomandë i ankesës e jo sikurse që thekson e paditura. Më tutje thekson se e paditura nga paditësi në emër të borxhit kërkon 2.469.35, kurse në realitet ky borgj është joreal dhe i paqëndrueshëm me arsyetim se llogaria lidhur me shfrytëzimin nuk është bërë sipas gjendjes ekzistuese e aq më tepër kur dihet se më tepër se katër vite në lokal nuk ka ekzistuar ujëmatësi e mos ekzistimi i ujëmatësit në market është kryekëput faj i Komisionit përkatës i Korporatës. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin aprovohet padia e paditësit dhe anulohet vendimi i Komisionit Këshillues

për Konsumatorë me nr. 115/2015 i datës 10.05.2017 dhe lëndën përsëri t'ia kthej KKK Korporatës HJ.Sh.a. në Prizren në riprocedurë dhe vendosje të drejtë.

Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigjen në padi të datës 18.11.2019 ka deklaruar se: *“pretendimi i paditësit se ankesa është parashtruar brenda afateve ligjore është tërësisht e pabazë dhe e pambështetur në fakte, sepse duke u bazuar në librin e pranim-dorëzimit të KRU “Hidroregjioni Jugor”, paditësi është njoftuar për aktin administrativ nr. 4347/20/12/2016 i datës 07.03.2017 të Komisionit të shkallës së parë në procedurën administrative me datë 15.03.2017, përderisa i njëjti ka pasur afat që ankesën ta parashtroj në Komisionin Këshillues për Konsumatorë për Rajonin e Prizrenit brenda tridhjetë ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa e paditësit ishte dorëzuar me 22 Prill 2017 në Komisionin Këshillues të Konsumatorëve, që do të thotë se paditësi nuk i kishte respektuar afatet ligjore për parashtrimin e ankesës në shkallën e dytë në procedurën administrative ashtu që e paditura hodhi poshtë ankesën si të paafatshme sipas nenit 129, paragrafi 1.4 i LPPA-së. Më tutje e paditura thekson se bazuar në shënimin zyrtar P.nr. 425/2016 i datës 12.06.2019 paditësi ka pranuar borxhin dhe ka arritur marrëveshje me KRU “Hidroregjioni Jugor” që detyrimet për shërbimet e ujit të cilat janë kontestuar, t'ia paguaj ofruesit të shërbimeve me këste sipas marrëveshjes së arritur pranë Përmbauesit Privat.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i të paditurës deklaroi: *“Mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe kërkojmë nga Gjykata që të marre vendim refuzues ndaj padisë dhe të vërtetojë vendimin e Komisionit Këshillues të Konsumatorëve regjioni i Prizrenit te dt. 07.03.2017,sepse konsumatori apo paditësi tashmë me ofruesin e shërbimeve ka arritur marrëveshje me anë të procedurës përmbaimore për shlyerjen me këste të obligimeve të cilat i ka kontestuar në të dy shkallët e procedurës administrative”.*

Më tutje, në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i të paditurës deklaroi: *“Kërkoj nga Gjykata të vërtetojë vendimin e Komisionit Këshillues të Konsumatorëve regjioni i Prizrenit dhe të refuzojë padinë e paditësit dhe të marrë për bazë argumentet e paraqitura duke përfshirë edhe marrëveshjen me përmbauesin privat”.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi i ARRSHU nr.115/2017 i dt.10.05.2017, ankesa me numër reference 4347 e dt.22.04.2014, vërtetimi mbi pranimin e dërgesës ,numri i pranimit 5439825(data nuk shihet), vendimi i KRU Hidroregjioni Jugor me numër reference 4347/20.12.2016 i dt. 07.03.2017, kopja nga libri i pranim-dorëzimit i dt. 15.03.2017, shënimi zyrtar nga përmbauesi privat Enis Hoxha nën shenjen P.nr.425/2016 i dt. 12.06.2019, regjistri i leximit te ujëmatëseve në emër te paditësit, fotografia e ujëmatësit, procesverbali i dt. 21.12.2016, formulari i ankesës-kërkesës i dt. 20.12.2016, kartela e klientit e dt. 20.12.2016, kartela e klientit e dt. 14.11.2019, kartela e klientit e dt. 27.12.2019 si dhe kartela e klientit e dt. 24.04.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar nga ana e të paditësit është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Gjykata gjeti se e paditura me vendimin e saj, ligjshëm ka konstatuar se paditësi R. K. në bazë të dëshmive të ofruara, vendimin e organit administrativ të shkallës së parë e ka pranuar me datë 15.03.2017 dhe këtë fakt gjykata e vërtetoi me kopjen nga libri i pranimit-dorëzimit, i cili mban datën 15.03.2017 dhe numri rendor 3 në të cilin ka nënshkruar paditësi.

Gjykata po ashtu konstatoi se paditësi kishte parashtruar ankesë tek e paditura me datë 22.04.2014, ashtu që e paditura ligjshëm kishte konstatuar se ankesa është bërë jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, rrjedhimisht ankesa e paditësit nuk i kishte përmbushur kushtet e nevojshme nga neni 127, paragrafi 1 dhe neni 129, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata po ashtu gjeti se paditësi kishte filluar procedurën e përmbartimit, respektivisht të shlyerjes graduale të borxhit i cili kontestohet përmes kërkesës së paditësit për anulimin e aktit administrativ të kontestuar dhe kjo u vërtetua përmes Shënimit Zyrtar të përmbartuesit privat Enis Hoxha nën shenjën P.nr. 425/2016 i datës 12.06.2019.

Gjykata refuzoi pretendimet e paditësit të përfshira në padi rreth asaj se ekspedimi i ankesës së tij ishte bërë përmes postës rekomandë, për faktin që vërtetimi mbi pranimin e dërgesës, nuk përmban asnjë datë të dukshme me të cilën do të vërtetohej një pretendim i tillë i paditësit.

Gjykata erdhi në përfundim se vendimi i kontestuar i të paditurës në mënyrë të qartë ka përshkruar dhe vlerësuar veçanërisht aspektin formal e procedural që është zhvilluar përgjatë gjithë trajtimit të çështjes administrative të paditësit.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerëson se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar juridike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thënie të paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër juridike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 1005/17, datë 06.04.2021

G j y q t a r i

---

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.